



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë, më, 14.11.2017

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”, në mbledhjet e tij të zhvilluara në datë 6, 7, 8, dhe 14 nëntor 2017.

Komisioni zhvilloi 4 seanca ku u njoh me projektbuxhetin e vitit 2018 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Komisioni u njoh me projektbuxhetin e vitit 2018 nga zv/Ministri i Financave z. Luçi. Projektbuxheti i vitit 2018 synon të përmbushë objektivat kryesore të programit ekonomik 2017-2020, fokusuar në rritjen ekonomike dhe investimet publike, rritjen e të ardhurave, mbështetjen e reformave, uljen e borxhit, si dhe vazhdimin e konsolidimit fiskal. Buxheti 2018 është konceptuar dhe bazuar kryesisht në rritje ekonomike të lartë e gjithëpërfshirëse dhe në vijimin e uljes së borxhit publik.

Parashikimet kryesore të projektbuxhetit 2018 janë si më poshtë:

- Rritje ekonomike prej 4,2%. Buxheti do të mbështesë sektorët që kontribuojnë në zhvillimin e modelit të ri ekonomik, formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë, thellimin e decentralizimit, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e mëtejshëm të mirëqenies së qytetarëve;
- Politikat fiskale do të vijojnë të bazohen në taksim të ndershëm;
- Investimet publike janë planifikuar në masën 5.2% e PBB ose 86.1 miliardë lekë. Nxitja e investimeve në sektorët strategjikë si turizmi apo dhe në sektorë me performancë në rritje si teknologjia e informacionit dhe komunikimit apo nënsektori i peshkimit;
- Fokusimi më i mirë te projektet infrastrukturore. Një pjesë e madhe e tyre në vitin e dytë, pas vitit 2018, do të përfundojnë duke i lënë hapësirë edhe hapjes së projekteve të tjera të mëdha, si Rrugës së Arbrit, për të nxitur rritjen e konektivitetit sidomos me vendet e rajonit dhe optimizmin e rrjetit aktual.
- Reformat, si reforma në drejtësi, reforma e pensioneve, reforma e kompensimit të pronarëve, reforma administrativo-territoriale, reforma e ujit, si dhe reforma e administratës publike dhe e financave publike;

- Niveli i të ardhurave, që është në një nivel të lartë historik në mbi 28% e PBB-së do të arrihet që këtë vit. Ato synohet të jenë 464,3 miliardë lekë. Konsolidimi i këtij niveli të ardhurash bazohet tek përmirësimi administrativ dhe lufta kundër informalitetit;
- Shpenzimet parashikohen me një rritje prej 3,8% në krahasim me vitin 2017, dhe kapin nivelin 496,6 miliardë lekë, ose ose 30.1% e PBB-së;
- Niveli i borxhit publik të targetuar, do të ulet me rreth 2.5 pikë përqindje dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;
- Defiçiti buxhetor për vitin 2018 planifikohet të jetë në nivelin 2.0% të PBB-së. Balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.6% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të dytin vit radhazi;

1 – MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Z. Niko Peleshi. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Për vitin 2018 buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është rreth 10.946 miliardë lekë dhe ka një rritje me 15% në krahasim me buxhetin e vitit actual, ndërsa zëri i investimeve 11%. Ky buxhet është i ndarë në programe buxhetore, ku më të rëndësishmit dhe prioritarët janë mbështetja për fermerin, infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, siguria ushqimore, zhvillimi rural, Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor dhe menaxhimi i peshkimit. Bujqësia vazhdon të mbetet në 20% të PBB-së.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme sipas zërave më poshtë:

• Mështetja për fermerin

Ky buxhet synon rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë e për rrjedhojë uljen e kostove të prodhimit. Investimet në këtë program për vitin 2018 në raport me vitin 2017 janë rritur me 55%. Objektiva konkretë janë:

- Rajonizimi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral mbi bazën e potencialeve specifike sipas rajoneve, duke sjellë për pasojë rritjen e efektivitetit të mbështetjes financiare;
- Zgjerimi i skemës së mbështetjes për fermerët dhe formalizimin e tyre në mënyrë që të mund të përfitojë nga këto skema.

• Siguria Ushqimore

Investimet në këtë program për vitin 2018 në raport me vitin 2017 janë rritur me 10%. Objektiva konkretë janë:

- Ruajtja e situatës epizootike të vendit nëpërmjet imunizimit të bagëtive të imëta dhe gjurmimit të sëmundjes së brucelozës në gjedhë në 10% të krerëve;
- Reduktim në masën 10% të parazitëve karantinor me qëllim ruajtjen e sipërfaqeve të mbjella;
- Rritja e biodiversitetit nëpërmjet subvencionimit në masën 100% të racave në rrezik zhdukje;
- Vaksinimi i kafshëve të imta prej 3 milion për të mundësuar eksportin e tyre në vendet e Bashkimit Europian;
- Krijimi dhe mbajtja e kadastrës së vreshtarisë dhe verës dhe të ullirit të cilat do të mbulojnë identifikimin, regjistrimin, hedhjen e të dhënave në system sipas qarqeve (në nivel fshati);

- **Peshkimi**

Investimet në këtë program për vitin 2018 në raport me vitin 2017 janë rritur me 15%. Objektiva konkretë janë:

- Ngritja e sistemit VMS (instalimi i transponderave) për anijet e peshkimit;
- Ndërtimi i Tregut të peshkut Shëngjin;
- Dokumenti Sektorial për Peshkimin (IPA II)

- **Ujitja dhe Kullimi**

Rrjeti sekondar dhe terciar i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit i ka kaluar në administrim bashkive. Investimet në këtë program për vitin 2018 në raport me vitin 2017 janë rritur me 15%. Objektiva konkretë janë:

- Pastrimi i 266 km të rrjetit të kanaleve kryesore kulluese, rindërtimi i 128 km tokë;
- Rehabilitim i kanaleve të kullimit me qëllim kullimin dhe mirëmbajtjen e 280 ha tokë;
- Përfundimi i projektit ekzistues të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes të Bankës Botërore me rehabilitimit të ujitjes në 25 ha;
- Vazhdimi i rehabilitimit të rrjetit kryesorë të kanaleve të kullimit për fushën e Torroviçës në Lezhë dhe Fushën e Mliqit në Korçë;
- Përfundimin e rehabilitimit të kanaleve kryesore ujtëse në administrim të 4 bordeve rajonale të kullimit;
- Rehabilitimin e argjinaturave mbrojtëse të tokave bujqësore në zonat më të rrezikuara;
- Ofrimi dhe përmirësimi i sistemeve kryesore të kullimit, për rreth 45000 ha më shumë;
- Ndërtimi dhe rehabilitimi i 18 km argjinatura përgjatë lumenjëve;
- Sigurimi i shërbimeve të sigurta dhe të qëndrueshme të kullimit me ngritje mekanika me pompa për 70000 ha tokë bujqësore;

- **Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor**

Investimet në këtë program për vitin 2018 në raport me vitin 2017 janë rritur me 2%. Objektiva konkretë janë:

- Orientimi drejt zinxhirit të vlerës për produktet bujqësore e blegtorale me qëllim plotësimin e standardeve që mundësojnë eksportimin e tyre;
- Rritja e numrit të fermerëve të kontaktuar dhe këshilluar nga shërbimi këshillimor publik në 12 qarqet në 75,000 në vitin 2018;
- Përfshirja me madhe e pedagogëve të Universitetit bujqësor, për trajnimin e ekstensionistëve sidomos për aspektet e menaxhimit ekonomik dhe financiar të fermave, marketingut dhe përpunimit të produkteve do të ndikojë në plotësimin e boshllëqeve që kanë ekstensionistët për njohuri të tilla;

Diskutimet u përqëndruan kryesisht në funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe transferimin e fondeve tek njësitë vendore në rast të transferimit të kësaj ifrastrukture tek ato; në shtimin e mbështetjes për fermerët dhe fuqizimi i skemave mbështetëse; shkrirje e drejtorive rajonale të bujqësisë dhe problematika që mund të krijohet sigurimi i statistikave; kontrolli i farërave dhe sigurimi i farërave

elitë; fokusimi tek siguria ushqimore në të gjitha aspektet e saj, si dhe në përmirësimin e statistikave në bujqësi në mënyrë që të formalizohen fermerët e të mundësohet përfitimi nga skemat mbështetëse; etj.

3- MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Z. Damian Gjijknuri dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Projektbuxheti i vitit 2018 në sektorin e infrastrukturës dhe energjisë parashikon një financim total prej 43 miliardë lekë. Për sa i përket mbështetjes në infrastrukturën rrugore dhe ujësjellësa në krahasim me atë të vitit 2017 ka një rritje të investimeve në këtë buxhet. Me këtë buxhet bëhet e mundur hapja e disa projekteve të reja, mbyllja e projekteve të nisur.

Ky buxhet synon të përmbushë objektivat e mëposhtme sipas fushave:

- **Energjia**

Mbështetja për energjinë do të vazhdojë edhe këtë vit. Janë lançuar programe të ndryshme të diversifikimit përfshirë edhe burime të tjera alternative të energjisë.

- Vijimi i financimi të ndërtimit të linjës së Interkoneksionit 400kv Shqipëri-Maqedoni me një vlerë investimi prej 70 milion Euro, e cila, së bashku me linjën 400kv të Kosovës, e rrit me afërsisht 80% kapacitetet e transmetimit ndërkombëtar të energjisë elektrike. Në vitin 2018 do të fillojë ndërtimi i veprës ndërlidhëse mes Shqipërisë dhe Maqedonisë për krijimin e një rrjeti modern për shkëmbimin e energjisë elektrike, gjë që bën përfundimisht lidhjen e Shqipërisë me të gjitha vendet e rajonit për sa i përket pikëpamjes energjitike dhe i jep mundësi prodhimit të energjisë shqiptare për të eksportuar në vende të tjera apo krijimit të bursës së energjisë në Shqipëri.
- Për vitin 2018 synohet që të rritet e prodhimit vendas i energjisë dhe të ulen nivelet e humbjeve teknike dhe jo-teknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së energjisë së importuar për përmbushjen e kërkesës me energji elektrike për vendin tone.
- Do të përfundojë zbatimi i projektit të financuar nga Kooperacioni Italian me qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e rrjetit shpërndarës të zonës Dhërmi-Sarandë, duke synuar rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për gjithë zonën e bregdetit Jon, me një fond të parashikuar rreth 16 milion Euro.

- **Infrastruktura**

Fokusi i investimeve do të jetë në akset kryesore kombëtare. Buxheti do të bëjë të mundur hapjen e disa kantierëve të reja shumë të rëndësishme për lidhjet, nyjet kryesore të transportit rrugor, siç është edhe mundësia për vazhdimin e një pjese të unazës, sidomos nyja që lidh nga ish-fabrika e birrës, pra nyja që lidhet me pjesën e unazës së sapopërfunduar me sheshin Shqiponja.

Për vitin 2018 është parashikuar hapja e projekteve të reja:

- Ndërtimi i Rrugës së Arbrit, si pjesë e projektit “1 Billion”. Është shpallur fitues për rrugën e Arbrit një nga kompanitë e cila ka marrë pjesë në garë dhe ka bërë ofertë, dhe është duke u negociuar faza finale e kontratës, dhe besoj vitin tjetër edhe kjo rrugë do të fillojë, do të investohet dhe do të bëhet realitet për disa vite.
- Investimet në korridorin Jonian-Adriatik marrin një përparësi shumë të madhe, për këtë ka shprehje interesi për të përfunduar segmentet e këtij korridori, të paktën në pjesën shqiptare nga kompani të interesuara private shqiptare apo edhe të huaja të cilat përmes skemës së PPP do të bëjnë të mundur të mundur përfundimin e segmentit nga Miloti deri në Kashar.
- Me buxhetin e 2018 është parashikuar të mbulohen totalisht me financim dhe të përfundojnë 10 segmente rrugore. Do të realizohet mbyllja e pjesës së mbetur nga Kukësi deri në kufi, pra pjesë e autostradës e cila ka mbetur e papërfunduar, pjesa tjetër do të përfundohet në bazë të kontratës koncensionare dhe shumë shpejt do të fillojë edhe aktivizimi i atyre pagesave që janë pjesë e kësaj kontrate.
- Vazhdimi i lotit të dytë Korçë – Ersekë, duke e lidhur përfundimisht Ersekën me një rrugë me transport modern duke e lidhur me pjesën tjetër të rrjetit kombëtar të rrugëve. Do të përfundojnë kantierët e nisura siç është Lin – Pogradec, përfshi edhe tunelin që do të bëhet në hyrje të Pogradecit.
- Ky buxhet mundëson edhe lidhjen e kontratave për by passin e Vlorës dhe by passin e Fierit, këto nyje kaq të rëndësishme që janë kthyer në gangrenë të madhe për transportin rrugor.
- Do të sigurohet kredia shtesë dhe do të përfundojë brenda 6 mujorit të parë të vitit tjetër dhe rruga Tiranë – Elbasan.
- Gjithashtu, do të bëhen studime fizibiliteti në drejtimin e hekurudhave, ku një nga projektet prioritare është projekti me BERZH-in për ndërtimin e rrjetit modern hekurudhor Tiranë - Rinas – Durrës.

• **Reforma e ujit**

Reforma e ujit është shumë e rëndësishme dhe disiplinimi i përdorimit të ujit, faturimi i ujit, mbledhja arkëtimi dhe fuqizimi ekonomik i ujësjellësave do të bëjë të mundur që Shqipëria të ketë një rrjet modern të ujësjellës kanalizimeve, është një nga sfidat e mëdha që ka ky vend.

Për vitin 2018 do të vazhdojnë investimet e nisura në ujësjellës kanalizime. Si rezultat i investimeve dhe mirëmenaxhimit (aksionit për ujin), pritshmëritë deri në fund të vitit 2018 janë:

- Shtimi i 200 mijë lidhjeve/kontratave për ujin e pijshëm;
- Shtimi i 100 mijë lidhjeve në sistemin e kanalizimeve;
- Zgjatja e orarit të furnizimit me ujë nga 12 orë/ditë – 14 orë/ditë;
- Norma e arketimit 95% nga 91%;
- Raporti i mbulimit të Kostove të Operimit (KTO) me të ardhurat 90% nga 81.2%.

• **Mbetjet urbane**

Objektivat e mbetjes urbane kanë një realizim të kënaqshëm, megjithëse në fazat e para dhe është një nga sfidat e mëdha që ka Shqipëria përsa i përket trajtimit të mbetjeve urbane, dhe do të jetë një sfidë e vazhdueshme e shoqërisë shqiptare edhe në të ardhmen për shkak të kostove të saj.

- Me këtë buxhet mundësohet edhe financimi i objektivave që ka qeveria përsa i përket mbetjeve urbane. Tashmë janë ngritur disa impiante dhe janë në proces të ndërtimit apo në fazën studimore disa projekte për landfille të reja, siç është landfilli i Vlorës, apo landfille të tjera të cilat janë kontraktuar nga qeveria shqiptare, përfshirë edhe ngritjen e impianteve të përpunimit të plehrave.
- Me këtë buxhet do të bëhet e mundur vazhdimi i këtyre investimeve, qoftë si fonde të kundërpartit lokal nga ana e qeverisë shqiptare, qoftë edhe si mbështetje për partneritetin publik privat për ato pagesa që i ka marrë përsipër qeveria shqiptare.

Diskutimet u përqëndruan në gjendjen aktuale të infrastrukturës rrugore e standardet e saj dhe në projekte të veçanta të saj; zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore; menaxhimi i mbetjeve urbane; planet vendore dhe përfundimi i procesit të planifikimit; problematikat në furnizimin me ujë dhe projektet në infrastrukturë e ujësjellës – kanalizime; investimet në sektorin e energjisë; etj.

4- MINISTERIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri z. Blendi Klosi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2018 do të jetë rreth 2.16 miliardë lekë dhe në tërësinë e tij, shënon një rënie krahasuar me një vit më pare.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme si:

- **Turizmi**

Mbështetja buxhetore që merr turizmi në këtë buxhet është 42% më e lartë se ajo e vitit aktual përsa i përket investimeve. Ministria synon që turizmi të mos jetë thjesht industri shërbimesh, por një industri që kontribuon në rritjen ekonomike. Disa nga prioritetet janë si më poshtë:

- Promovimi i investimeve në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera publike të nxitjes së investimeve në vend;
- Përmirësimi i infrastrukturës turistike në zonën bregdetare me sinjalistikë, si dhe rivitalizimi i Via Egnatias;
- Zhvillimin e destinacioneve turistike dhe burimeve për të ofruar produkte konkurruese në katër destinacione për turizmin e natyrës, 6 për turizmin kulturor dhe 4 destinacione për turizmin e bregdetit;
- Promovimi i agroturizmit duke përfshirë zonat rurale në zhvillimin e turizmit;
- Përmirësimi i identitetit shqiptar të turizmit në rajon e më gjerë nëpërmjet një strategjie të re marketingu për turizmin; etj

Gjithashtu një nxitje i jepet zhvillimit të turizmit me anë të paketës fiskale, e cila favorizon krijimin e standardeve të reja dhe parashikon lehtësira fiskale në standardet e strukturave akomoduese të turizmit me status special, konkretisht struktura të vlerësuara si njësi akomoduese me 4 ose 5 yje.

- **Mjedisi**

Mjedisi është pjesë e rëndësishme e Minsitrisë. Prioritet vazhdojnë të mbeten programe që shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

- Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit të Mjedisit Urban;
 - Monitorimi i Cilësisë së Ujrave;
 - Hartimi dhe përmirësimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës në kuadër të përafrimit ligjor të Bashkimit European;
 - Edukimi i brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes;
 - Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve;
 - Nxitja e partneritetit publik-privat;
 - Integrimi i ndryshimeve klimatike në sektorët e energjisë, ujrave, bujqësisë, zhvillimit urban dhe infrastrukturës;
 - Mbrojtja dhe përmirësimi i menaxhimit të Zonave të Mbrojtura;
- **Administrimi i pyjeve**
 - Hartimi i Inventarit Kombëtar të Pyjeve;
 - Regjistri Unik Kadastral Kombëtar;
 - Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor;
 - Zbatimi i skemës së granteve konkurruese;
 - Hartimi i metodologjisë dhe implementimi i saj për sekuestrimin e karbonit;
 - Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe eliminimi i gjuetisë së paligjshme.

Gjatë prezantimit, Ministri Klosi u ndal tek projekti “Për një Shqipëri më të pastër”.

Diskutimet u përqëndruan kryesisht tek mbrojtja e mjedisit; zhvillimi i veprimtarisë së gjuetisë; ecuria e administrimit të pyjeve dhe fondet e akorduara për to; politikat e mbrojtjes së pyjeve; procesi i menaxhimit të mbetjeve dhe format që kanë prioritet në këtë proces sipas politikave të ministrisë; ecuria e ndërtimit të *landfill*-eve të ndryshme; pwrçaktimi i zonave turistike; incentivat për zhvillimin e turizmit e vecanërisht për ato që lidhen me agroturizmin; lejet e zhvillimit që planifikohet të jepen zonat turistike; etj.

5- GRUPE INTERESI

Gjatë shqyrtimit të buxhetit 2018, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të grupimit “Ekolëvizja” të cilët ngritën shqetësimin e tyre në lidhje me buxhetimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, konkretisht për pamjaftueshmërinë e fondeve buxhetore afatshkurtra dhe afatmesme në lidhje me një menaxhim më të mirë të mbetjeve tek bashkitë.

Disa nga propozimet e këtij grupimi në lidhje me këtë buxhet dhe qasja e tij ndaj mjedisit janë si më poshtë:

- shtimi i transfertës së pakushtëzuar për bashkitë në mënyrë që të përballojnë menaxhimin e integruar të mbetjeve në territoret përkatëse;

- të vendoset një destinacion për taksat në fushën e mjedisit, duke i investuar ato të ardhura po në çështje mjedisore;
- shtimi i masave administrative me gjobë për ndotësit e mjedisit;
- buxhetimi afatshkurtër dhe afatmesëm shton investimet në incenerim, që është një nga elementet më pak të dëshiruara nga legjislacioni dhe forma e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Në trajtimin e kërkesave të këtij grupimi, deputetët argumentuan që me ndarjen e re territoriale grumbullimi i mbetjeve nga bashkitë është dyfishuar; grumbullimi i mbetjeve lidhet ngushtë me trajtimin e tyre gjë që kërkon infrastrukturën e përshtatshme për këtë qëllim, siç është rasti i inceneratorëve të cilët gjatë procesit prodhojnë dhe energji; po merret në konsideratë rishikimi i strategjisë së mbetjeve nga GIZ-i, pasi dy strategjitë e mëparshme nuk rezultojnë të aplikueshme. Gjithashtu, deputetët i siguruan përfaqësuesit e Grupimit “Ekolëvizja” që po përgatitet një paketë ligjore shumë e ashpër në drejtim të shkeljeve mjedisore.

Pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2018 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord në parim me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”.

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar